

URDHËR
Nr. 638, datë 3.9.2019

PËR NDRYSHIMIN E KALENDARIT KOMBËTAR TË VAKSINIMIT

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 30, të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, i ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr. 15/2016, datë 10.3.2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, referuar vendimit të Komitetit Kombëtar të Imunizimit nr. 2, datë 12.4.2018,

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e kalendarit të vaksinimit, si më poshtë vijon:
 - a) fëmijët e lindur që nga data 1 gusht 2019, do të fillojnë kalendarin e vaksinimit me vaksinën e Rotavirusit, vaksinë e gjallë dhe e dobësuar, e cila merret nga goja;
 - b) vakcina e Rotavirusit futet në kalendarin kombëtar të vaksinimit me 3 doza, përkatësisht në moshat 2, 4 dhe 6 muaj;
 - c) fëmija i lindur më 1 gusht 2019, që mbush moshën 2 muaj, më 1 tetor 2019, fillon vaksinimin me këtë vaksinë;
 - d) vakcina e Rotavirusit do të administrohet në të njëjtën ditë me vaksinat e tjera të kalendarit, DTP-HepB-Hib, PCV13 dhe IPV/OPV.
2. Operatori i Kujdesit Shëndetësor, në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik të koordinojnë të gjithë veprimtarinë për fillimin e vaksinimit me këtë vaksinë, më 1 tetor 2019, në të gjithë vendin.
3. Operatori i Kujdesit Shëndetësor, të njihet me kalendarin e ri të vaksinimit dhe rekomandimet e Institutit të Shëndetit Publik, si edhe të marrë masa për zbatimin e tyre në të gjitha njësitë vendore të kujdesit shëndetësor.
4. Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor të marrin masa dhe të sigurojnë shpërndarjen, ruajtjen dhe aplikimin në kushtet standarde të vaksinës së Rotavirusit.
5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor:
 - a) të njihet me kalendarin e ri të vaksinimit, si edhe të marrë masa për zbatimin e tyre nga çdo Qendër Shëndetësore;
 - b) të sigurojë kartelat e reja sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit, bashkëngjitur këtij urdhri;
 - c) të sigurojë regjistrat e vaksinimit, sipas kalendarit të ri të vaksinimit për çdo qendër shëndetësore.
6. Ngarkohen Instituti i Shëndetit Publik, Operatori i Kujdesit Shëndetësor, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin dhe monitorimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

Kalendari i vaksinimit për fëmijët 0-18 vjeç

[illegible]